



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science,

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.7, nenit 8 dhe shtojcës 7 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 09.08.2023, nenit 32, paragrafit 4 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës të datës 14 shtator 2011, nenit 11 Udhëzimit administrativ nr. 20/2023 të datës 04.08.2023 për Krijimin e Skemave për Mbështetje Financiare të Studentëve për Ndarjen e Bursave si dhe Vendimit Nr. 01- 263, të datës: 04.06.2026, nxjerr:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për studentet në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM) të arsimit të lartë në Kosovë

Thirrja synon ta mbështesë shkollimin e studenteve vajza/gra që studiojnë në nivelin Baçelor në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në programet e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo ndryshe të njohura si STEM në gjuhën angleze), në vlerë prej 1000 (njëmijë) EUR/për vit për studente.

PËRSHTATSHMËRIA E KANDIDATEVE PËR APLIKIM

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha studentet vajza/gra të nivelit Baçelor që janë të regjistruara dhe vijojnë studimet në një nga programet e fushave STEM në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

Në këtë thirrje inkurajohen që të aplikojnë studentet nga komunitetet joshumicë, ato me aftësi të kufizuar dhe ato që vijnë nga zonat rurale.

Kushtet dhe kriteret për aplikim

1. Të jenë shtetase të **Republikës së Kosovës**;
2. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentet e nivelit Baçelor të regjistruara për herë të parë në vitin akademik 2025/2026 në programet STEM, të cilat kanë dhënë së paku 2 provime të semestrit të parë të studimeve;
3. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentet në studime të rregullta, që ndjekin ligjëratat në mënyrë aktive sipas rregullave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera të universitetit që përcaktojnë obligimet dhe detyrimet për student të rregullt;
4. Të kenë llogari bankare personale - aktive (në emër të aplikueses), në njërën nga Bankat e Republikës të Kosovës;
5. Kushtet dhe kriteret nuk vlejnë për studentet me aftësi të kufizuara dhe ato mund të përfitojnë bursë brenda dyfishit të afatit të rregullt të studimeve të parapara me legjislacion në fuqi, varësisht nga kohëzgjatja e programit.

PROCESI I APLIKIMIT

Procesi i aplikimit do të realizohet online përmes platformës e-Kosova.

Për të aplikuar, kandidatet duhet të plotësojnë këtë dokumentacion:

1. Skanimi dhe ngarkimi i letërnjoftimit;
2. Dëshmia/vërtetimi për statusin e studentes (origjinale, i nënshkruar dhe vulosur nga IAL);
3. Pasqyra e notave (origjinale, e nënshkruar dhe vulosur nga IAL);
4. Nëse aplikohet, formulari i vetëdeklarimit të përkatësisë etnike (për komunitetet joshumicë);
5. Nëse aplikohet, për personat me aftësi të kufizuara sipas kushteve dhe kriterëve për aplikim të ngarkojnë dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente përkatëse.

Forma dhe procedurat e aplikimit:

Aplikimi bëhet përmes platformës e- Kosova.

Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në fazën e parë të vlerësimit teknik.

Konkursi është i hapur nga **08.06.2026 deri më 22.06.2026**

VËREJTJE:

- Aplikimet e dorëzuara në formë fizike, përmes postës, email-it apo ndonjë formë tjetër nuk do të pranohen dhe si të tilla nuk do të shqyrtohen nga komisioni vlerësues.
- Kandidatet janë përgjegjës për plotësimin e saktë dhe të plotë të aplikacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.
- Aplikimet me mungesë dokumentacioni, të paqarta ose të dorëzuara jashtë platformës elektronike do të konsiderohen të pavlefshme dhe do të refuzohen në fazën e parë të vlerësimit teknik.
- **Studentet nuk mund të përfitojnë bursë të dytë nga fondet publike të Republikës së Kosovës për të njëjtin vit akademik të studimit, pavarësisht nëse:**
 - kanë ndërruar programin e studimit;
 - kanë kaluar në një institucion tjetër;
 - janë të regjistruara në dy institucione të AL;
 - kanë aplikuar në më shumë se një skemë brenda afatit të thirrjeve.
- Gjatë aplikimit, studentet mund të aplikojnë në më shumë se një thirrje të MASH, por në rast të përzgjedhjes në më shumë se një skemë, **do të përfitojë vetëm një bursë**, sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe renditjes përfundimtare, përjashtimisht përfituesve të bursës elitare.
- MASH, rezervon të drejtën të bëjë verifikimin e të dhënave dhe eliminimin e aplikimeve të dyfishta, në përputhje me këtë rregull.
- Aplikueset janë të obliguara të paraqesin dokumentacion të saktë dhe të lëshuar nga organet kompetente. Paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, deklarimeve të rrejshme apo dokumenteve që nuk janë të lëshuara nga institucionet zyrtare, përbën vepër penale, e dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe mund të rezultojë me refuzimin e menjëhershëm të aplikimit si dhe ndjekje penale (Ligji për procedurë administrative: Ligji nr. 05/L-031- neni 13 Parimi i vërtetësisë- Palët janë të obliguara të japin informata të sakta dhe të mos paraqesin fakte të rreme).

VËMENDJE PËR STUDENTET E VITIT TË PARË (NIVELI BAÇELOR):

Studentët që për herë të parë kanë regjistruar studimet Bachelor në fushat STEM në vitin akademik 2025/2026, mund të aplikojnë në këtë thirrje.

Kjo për shkak se qëllimi i thirrjes është të përfshijë studentet që kanë përfunduar së paku dy provime të semestrit të parë të studimeve, në mënyrë që të vlerësohet më mirë përkushtimi dhe vazhdimësia në programin e përzgjedhur.

ANEKS-LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË FUSHAVE- STEM

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”			
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Prodhimi Shtazor	Prishtinë	BSc
2	Prodhimi Bimor	Prishtinë	BSc
3	Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	Prishtinë	BSc
4	Mjekësi Veterinare	Prishtinë	BSc
5	Ekonomi e Bujqësisë	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit			
1	Inxhinieria e Ambientit	Prishtinë	BSc
2	Konstruktiv	Prishtinë	Bsc
3	Hidroteknik	Prishtinë	BSc
4	Gjeodezi	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Arkitekturës			
1	Arkitekturë	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike			
1	Elektroenergjetikë	Prishtinë	BSc
2	Elektronikë, Automatizim dhe Robotikë	Prishtinë	BSc
3	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	Prishtinë	BSc
4	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	Prishtinë	BSc

Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave të Natyrë			
1	Biologji	Prishtinë	BSc
2	Kimi	Prishtinë	BSc
3	Kimi Inxhinierike	Prishtinë	BSc
4	Shkencë Kompjuterike	Prishtinë	BSc
5	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	Prishtinë	BSc
6	Gjeografi	Prishtinë	BSc
7	Fizikë	Prishtinë	BSc
8	Matematikë	Prishtinë	BSc
9	Matematikë Financiare në Banka dhe Siguri	Prishtinë	BSc
10	Biologji Molekulare	Prishtinë	BSc
11	Kimi Ushqimore	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike			
1	Mekatronikë	Prishtinë	BSc
2	Komunikacion dhe Transport	Prishtinë	BSc
3	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	Prishtinë	BSc
4	Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	Prishtinë	Bsc
5	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment	Prishtinë	BSc
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Teknologji	Mitrovicë	Bsc
2	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	Mitrovicë	Bsc
3	Inxhinieri Minerare	Mitrovicë	Bsc
4	Gjeologji	Mitrovicë	Bsc
5	Materiale dhe Metalurgji	Mitrovicë	Bsc
6	Inxhinieri Ekonomike	Mitrovicë	Bsc
7	Inxhinieri Mekanike	Mitrovicë	Bsc

8	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Mitrovicë	BSc
Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Ekologji e Aplikuar në Agrobiznes	Pejë	BSc
2	Teknologji Ushqimore	Pejë	BSc
3	Teknologji e Prodhimit Bimor	Pejë	BSc
4	Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi	Pejë	BSc
Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi	Prizren	BSc
2	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Boshnjakisht	Prizren	BSc
3	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Turqisht	Prizren	BSc
4	Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit	Prizren	BSc
5	Agrobiznes	Prizren	BSc
6	Dizajn Softuerik	Prizren	BA Profesional
Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Shkenca Kompjuterike	Gjilan	BSc
Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Informatikë Inxhinierike	Gjilan	BSc

Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Inxhinieria Industriale me Informatikë	Ferizaj	BSc
2	Informatika e Aplikuar	Ferizaj	BSc
3	Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobileve	Ferizaj	BSc
4	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri	Ferizaj	BSc

Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
2.	Teknologji dhe Informatikë e Aplikuar	Mitrovicë	BA profesional
3.	Menaxhim i Mjedisit dhe Teknologji	Mitrovicë	BA profesional